



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK

Vlorë, më _____.____.2024

Lënda: Argumentim për vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit

Objekti i kontratës "Blerje Kite dhe Reagente"

REF-95128-02-12-2024

Loti I - Biokimik + koagulum

Loti I - REF-95131-02-12-2024

Loti II - Hemokrom per aparate "Abagus 3ct"

Loti II - REF-95133-02-12-2024

Loti III - Hemokrom per aparate "Hemiks 5sfri"

Loti III - REF-95135-02-12-2024

Lloji i procedurës: *Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor (AK) për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të Ligjit Nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" në nenin 77 pika 1 dhe pika 4, i cili parashikon se: "[...] Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas njëstandardi të përshtatshëm cilësie".

Në bazë të kriterëve të veçanta të kualifikimit hedhur në sistemin e APP^{së} sipas Dokumentave Standarte të Tenderit (DST) AK hartoi DST^{ën}, mbështetur në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke përcaktuar kërkesat e veçanta për kualifikim.
(*përveç kriterëve të përgjithshme që janë të pa ndryshueshme në DST*)

Për sa më sipër AK argumenton këto kriterë, referuar VKM Nr.285/ 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V "Dokumentet e Tenderit":

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij objektin e kësaj procedure prokurimi.

Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 pika 1 ku për të vërtetuar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës kryen veprimtari sipas objektit të procedurës së prokurimit, AK kërkon nga OE paraqitjen e një dokumenti ligjor i cili shërben për të vërtetuar veprimtarin që OE kryen si dhe është ose jo në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vertetim nga dega e tatim taksave ku te vertetohet realizimi i xhiros mesatare vjetore per 3 (tre) vitet e fundit (2021, 2022, 2023) e cila duhet te kete nje vlere jo me te vogel se vlera e fondit limit te lotit/loteve te vene ne dispozicion.

Operatori ekonomik nëpërmjet deklaramit të xhiros vjetore, duhet të tregojë nëse ka kryer xhiro për vitet e kërkuara, me një vlerë jo më të vogël se fondi limit i lotit/ loteve që do prokurohet. Kjo kërkesë mbështetet në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 1: kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2.2.2 Kopje te çertifikuara bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, nga të cilat dalin qartë të dhënat për vlerat e furnizimeve, për vitet 2021, 2022.

Vendosja e kërkesës, është në mbështetje të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" , neni 77 [...] në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën [...] si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 4 [...] operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.3. Për kapacitetin teknik:

Referuar Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 77 pika 4 parshikon: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

2.3.1 Furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë deri në 40% të fondit limit të lotit/ loteve për të cilat OE merr pjesë. Furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) nga data e zhvillimit të tenderit.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori pjesëmarrës duhet të paraqesë, vërtetim të lëshuar nga enti publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes dhe kontratat, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri tregon faktin që operatorët ekonomikë kanë realizuar gjatë tre viteve të kërkuesit kontrata të ngjashme të përmasave të tilla me objektin që prokurrohet. Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik", neni 77 pika 4 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 2/c.

2.3.2 Dokument me të cilin provohet se janë shlyer detyrimet vendore për vitin 2023, lëshuar nga administrata tatimore vendore.

AK ka vendosur këtë kërkesë për të vërtetuar se operatorët ekonomikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e kërkuesit për realizimin e kontratës janë të regulltë në pagesat e taksave vendore të vendit ku ata do të ushtrojnë aktivitetin e tyre, taksat të cilat çdo subjekt që kryen një aktivitet ekonomik duhet të paguhen, si dhe për të mos patur detyrime ekonomike ndaj Institucioneve Shtetërore. Referuar ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 45 pika 3.

Referuar Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 79 pika 1 parashikon se: *Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuesit të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.*

2.3.3 Çertifikatë ISO 9001-2015 për prodhuesin e produkteve të ofruara (ekuivalente) – në rastin e shpalljes fituese të operatorit ekonomik kurse në rastet kur dorëzon kërkesën për pjesëmarrje mund të sjellë një vetdeklarim në lidhje me prodhuesin që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

2.3.4 Çertifikatë ISO 9001-2015 për ofertuesin (ekuivalente).

Çertifikatat ISO 9001-2015 përcaktojnë kriteret për një sistem të administrimit të kualitetit. Nepermjet implementimit të kësaj norme ndërkombëtare Operatori Ekonomik provon aftësinë e tij për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme produkte të cilat janë në përputhje me kërkesat e klientit si dhe ato ligjore.

2.3.5 Çertifikatë konformiteti të markimit CE ose çertifikimit FDA sipas direktivës 93/42/EEC, për produktet e ofruara të vlefshme ose ekuivalente.

Certifikata e konformitetit është një dokument ku tregohen kriteret e përgjithshme që do të përdoren për projektimin dhe ndërtimin e disa kategorive të pajisjeve mjekësore në fuqi në BE. Kjo imponon që në produktet që do të tregohen duhet të jete shënuar shenja (logo) CE.

Këto kritere mbështen në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 79.

2.3.6 Vetedeklarim për origjinën e mallit ku të përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.

2.3.7 Kataloge të firmës prodhuese, ku të pasqyrohen specifikimet teknike për secilin artikull të ofruar. OE duhet të markojë në katalogun përkatës artikujt që ofron sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogu në kapakun e tij duhet të jete i vulosur nga ofertuesi.

2.3.8 Dokument (Autorizim) tregtimi nga firma prodhuese e artikujve të ofruar, me anën e se ciles autorizohet ofertuesi (distributori) për tregtimin e produkteve.

Reagentet duhet të jene ekuivalent por kompatibel me aparatoren STAGO, Mindry, Biolabo, HEMIX5-60 SFRI dhe DIATRO 3CT.

Për të pasur një cilësi sa më të lartë dhe produkte origjinale të ardhur nga firma prodhuese dhe jo nga firma fantazëm, kërkojmë nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të disponojnë deklaratë mbi origjinën, autorizimin nga firma prodhuese për operatorin shitës si dhe katalogët me specifikimet teknike përkatëse si dhe të vulosur nga operatori pjesëmarrës për efekt sigurie dhe autentikitet. Për këto kritere jemi bazuar në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 77 si dhe në nenin 79.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I AUTORIZUAR

ZYRTARI I AUTORIZUAR

Loreta Balaj